



REPubLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

DEKRET
PER
KTHIMIN E LIGJIT NR 8678, DATE 2.11.2000
“ PER ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
MINISTRISE SE DREJTËSISE ”

Në mbështetje të neneve 85 dhe 93 të Kushtetutës

DEKRETOJ:

Kthimin për rishqyrtim edhe njëherë në Kuvend të ligjit nr 8678, datë 02.11.2000 “ Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë ”

Tiranë, më 23.11.2000
Nr i dekretit 2804

PRESIDENTI I REPUBLIKES
REXHEP MEIDANI



Rexhep Meidani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

MOTIVIMI

I

**KTHIMIT TE LIGJIT NR.8678, DATE 2.11.2000
“PER ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E MINISTRISE SE DREJTESISË ”**

Të nderuar deputetë!

Ligjin nr. 8678, datë 2.11.2000 “ Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë ”, i cili më ka ardhur për shpallje në datë 14.11.2000, vendosa të mos e shpallë, por tua kthej edhe njëherë për rishqyrtim në Kuvend, me synimin e përmirësimit të disa dispozitave ligjore, të cilat unë i gjykova si kapërcim, sado i vogël, i parimeve të funksionimit në mënyrë të pavarur të pushtetit gjyqsor dhe të institucionit të prokurorisë.

Konkluzionet e mëposhtëme janë sintezë jo vetëm e mendimeve të juristëve me të cilët unë këshillohem, por janë edhe sygjerime të dërguara pranë institucionit të Presidentit të Republikës nga juristë të njohur e me përvojë, nga Konferenca Gjyqësore dhe nga organi i prokurorisë. Do të ndalem në disa prej tyre:

I. Në nenin 6, pika 9, dhe nenin 11, pika 3/b, të ligjit i është dhënë e drejta Ministrisë së Drejtësisë, që në përputhje me drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e qeverisë të ushtrojë veprimtarinë e saj edhe në *kryerjen e inspektimeve të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit.*

Unë gjykoj se dhënia e një kompetencë të tillë Ministrisë së Drejtësisë me një formulim të përgjithshëm, pa përcaktuar se deri ku janë kufijtë dhe pasojat e këtij inspektimi, përbën problem në funksionimin në mënyrë të pavarur të gjyqsorit dhe mund të lëjë shteg që ky inspektim i paspecifikuar edhe mund të çënojë dhënien e drejtësisë në mënyrë të pavarur nga gjyqtarët. Formulimet e bëra në nenet e cituar më lartë nuk janë në përputhje me parimet themelore kushtetuese të ndarjes së pushteteve dhe të pavarësisë së pushtetit gjyqësor (nenet 7 dhe 145 të Kushtetutës)

Vec sa më sipër ky ligj bie ndesh edhe me disa dispozita të ligjit nr 8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", ku në nenin 17 të tij është parashikuar se inspektimi i gjykatave bëhet nga inspektoriat i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, dhe se inspektoriat i Ministrisë mund të vihet në shërbim të të parit vetëm me kërkesën e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Duke qënë se ky ligj është miratuar pas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ai prezumohet se është në pajtim me të, si dhe amendamentet e mëpasme që i janë bërë tregojnë se është bërë një punë serioze dhe e menduar mirë. Nga ana tjetër përcaktimi në nenin 19 të ligjit "Për Ministrinë e Drejtësisë" se "*...edo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet*", të çon në përfundimin se një numër dispozitash të ligjit "Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor" janë shfuqizuar në mënyrë të nënkuptuar. Kjo mund të krijojë pasiguri dhe konfuzion në interpretimin dhe zbatimin e këtyre dy ligjeve. Ligji "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë" është një ligj organik që i përket fushës së pushtetit ekzekutiv, ndërsa ligji "Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor" i përket pushtetit gjyqësor. Mendoj se nuk është parimore, që një ligj për ekzekutivin të shfuqizojë dispozita të një ligji për gjyqsorin, qoftë ky dhe një shfuqizim i heshtuar apo i nënkuptuar.

2. Në nenin 6, pika 10, dhe nenin 11, pika 3/c, është parashikuar e drejta e Ministrisë së Drejtësisë të inspektojë dhe kontrollojë organin e prokurorisë për shkelje të ligjit.

Unë gjykoj se edhe këto formulime nuk janë plotësisht të përputhshme me pozicionin kushtetues të prokurorisë të parashikuar në nenet 148 e 149 të Kushtetutës, si dhe me parimet kryesore të Kodit të Procedurës Penale.

Kam ndjekur me vëmëndje, ashtu si dhe Ju të nderuar deputetë, diskutimet e shumta për vendin që duhet të kishte prokuroria në Kushtetutë, e vecanërisht ato që argumentonin vendin e prokurorisë si pjesë të ekzekutivit. Por, me miratimin e Kushtetutës ato qëndrime të atëhershme mbetën në minorancë dhe prokurorisë ju dha vendi i një organi të centralizuar, jashtë ekzekutivit, sic përcaktohet edhe në Kushtetutë, krahas bashkëpunimit dhe koordinimit të punës midis këtyre dy institucioneve që është po aq i dëshirueshëm dhe ligjor. Unë gjykoj se kontrolli i punës së prokurorëve për shkelje të ligjit duhet të bëhet nga Prokurori i Përgjithshëm, i ndihmuar nga stafi i tij. Vec këtij kontrolli, është gjykata ajo që kontrollon dhe thotë fjalën e fundit për zbatimin e ligjit në veprimtarinë e prokurorëve në hetimin e çështjeve konkrete. Është kundërta bie ndesh me parimin kushtetues të funksionimit të prokurorisë. Në nenin 148 të Kushtetutës është shprehur qartë se *“ Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve ”*.

3. Në nenin 4, të titulluar *“ Statusi i funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë ”*, parashikohet ndër të tjera, se gjyqtarët dhe prokurorët mund të pranohen të shërbejnë në funksionet politike të Kabinetit të Ministrit, dhe se ata, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtarë a prokurorë pa konkurs.

Mendoj se përcaktime të tilla bien ndesh me parimin e pavarësisë e të paanësisë së gjyqtarëve si dhe me statusin e tyre si funksionarë publikë të depolitizuar.

Vec sa më sipër është e nevojshme që në disa dispozita të ligjit të bëhen riformulime të sakta e të qarta. Kështu, psh në nenin 6, pika 9, është përcaktuar se “.....Ministria e Drejtësisë bën procedimin disiplinor të gjyqtarëve.....”, kur në bazë të ligjit një të drejtë të tillë e ka Ministri dhe jo Ministria, mandje vetëm për të inicuar procedimin disiplinor pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë ; në nenin 5, pika 2, është përcaktuar misioni i kësaj ministrie, vec të tjerash edhe si garant i respektimit të Kushtetutës, kur në bazë të Kushtetutës kjo e drejtë i njihet vetëm Gjykatës Kushtetuese (neni 124 i Kushtetutës) etj.

Të nderuar deputetë!

Të gjithë jemi pa dyshim për respektimin e parimit kushtetues-

“ *Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe në ballancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor* ”(neni 7 i Kushtetutës). Unë parashtrova me lartë disa shqetësime që lidhen me njërin anë të këtij parimi, respektimin e ndarjes së pushteteve dhe pavarësisë së tyre. Në lidhje me anën tjetër të tij, vendosjen e ballanceve dhe kontrollin reciprok të pushteteve, mendoj se kërkohet një kujdes më i madh në përcaktimin e mekanizmave që mund të realizojnë këto momente pa prekur parimin e ndarjes dhe pavarësisë së pushteteve. Pikërisht, kthimi dhe rishqyrtimi edhe njëherë në Kuvend i këtij ligji me këtë shqetësim, mendoj se do të reflektojë një variant që do të respektonte më mirë parimin e mësipërm.

Së fundi do t’Ju sygjeroja që rishqyrtimi në kohë i këtij ligji të bëhet së bashku me paketën tjetër ligjore të sistemit të drejtësisë e vecanërisht me ligjet “ Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë ” dhe “ Për

Prokurorinë “. Nga informacionet që kam konstatoj se është punuar për shumë kohë për përgatitjen e tyre, dhe se shumë nga shqetësimet e parashtruara më sipër mund të zgjidhen duke siguruar harmoni të plotë midis tyre dhe duke mënjanuar plotësisht kundërshtitë potenciale.

Duke shpresuar në mirëkuptimin Tuaj

**PRESIDENTI I REPUBLIKES
REXHEP MEIDANI**

A handwritten signature in cursive script, appearing to read 'Rexhep Meidani', written over a horizontal line.